Angazhimi në promovimin dhe të drejtat e grave, për mosdiskriminim në baza gjinore në asnjë fushë, për të drejta dhe detyrime të barabarta të gruas ashtu siç parashihen me ligjet në fuqi dhe me konventa ndërkombëtare.

Bashkëpunime me organizata vendore dhe të huaja; punëtori të ndryshme.

Sektori për Barazi Gjinore, ka objektiv rritjen e rolit të gruas në shoqëri.

Treguesit e performancës:

Treguesi: 1.1.1. - Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit

Gjatë periudhës 1.1.2025 deri më 30.11.2025, janë shqyrtuar 45.831 kërkesa, bashkëngjitur është raporti nga sistemi i intranetit.

Treguesi: 1.1.2. - Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore

Gjatë periudhës 1.1.2025 deri më 30.11.2025, janë 866 kërkesa të shqyrtuara me vonesë.

Treguesi: 1.1.3. - Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna.

Gjatë periudhës 1.1.2025 deri më 30.11.2025, janë lëshuar 890 certifikata të gjendjes civile në e-kiosqe.

Treguesi: 1.1.4. - Shërbimet administrative të thjeshtuara për zvogëlimin e barrës administrative në nivel komunal.

DREJTORIA PËR FINANCA DHE BUXHET

Gjatë kësaj periudhe të punës jemi përballur me zbatimin e kontratës kolektive në Arsim dhe Shëndetësi, një pjesë e madhe e mjeteve apo 2.428.557.85 euro janë ekzekutuar nga kategoritë: Mallra dhe Shërbime, Investime Kapitale dhe Subvencione, për zbatimin e kësaj kontrate.

Deri në këtë periudhë raportuese, shpenzimi i buxhetit është arritur në 96.98%, ndërsa të hyrat e përgjithshme janë tejkaluar në raport me planin në 12.57%.

➤ BUXHETI 2025

➤ Buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2025 ndahet në dy fonde burimore:

• Granti qeveritar	18,981,085.00 €
• Të hyrat vetanake	2,001,711.00 €
	Gjithsej: 20,982,796.00 €

➤ Buxheti final për vitin 2025 i shpërndarë sipas kategorive ekonomike:

• Paga dhe Mëditje	11,217,273.21€
• Mallra dhe Shërbime.....	2,811,100.03€
• Shpenzime Komunale	390,000.00€
• Subvencione dhe Transfere	1,060,000.00€
• Investime Kapitale.....	6,749,669.70€
	Totali: 22,228,042.94€

PUNËT E REALIZUARA JANAR - DHJETOR


➤ Gjatë kësaj periudhe, janë realizuar këto detyra:

- Zotime, pranime, shpenzime për mallra dhe shërbime, shërbime komunale, subvencione dhe transfere dhe investime kapitale;
- Përgatitja dhe dorëzimi i pasqyrave financiare për vitin 2024 në Ministrinë e Punës dhe të Transfereve;
- Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025;
- Shpërndarja e faturave të tatimit në pronë;
- Shpërndarja e vërejtjeve të tatimit në pronë;
- Përgatitja e raportit financiar në baza tremujore 2025 për Kuvendin Komunal dhe kryetarin e Komunës;
- Raportimi i obligimeve financiare dhe kontraktuale në baza mujore në Ministrinë e Financave;
- Përgatitja e raporteve mujore dhe tremujore (shpenzimet dhe të hyrat) për publikim në faqen ueb të Komunës.

JANAR- DHJETOR BUXHET, ALOKIM, SHPENZIM

Përshkrimi	Lëndët e kryera	Buxheti fillestar	Buxheti final	Alokimet	Shpenzimet	Shpenzim/ buxheti final %	Shpenzim/ alokim %
Paga dhe Mëditje	-	10,746,449.00	11,217,273.21	11,217,273.21	10,690,268.65	95.30	95.30
Mallra dhe Shërbime	1912	2,590,408.00	2,811,100.03	2,811,100.03	2,714,100.71	96.55	96.55
Shpenzime Komunale	502	390,000.00	390,000.00	390,000.00	368,065.35	94.38	94.38
Subvencione dhe Transfere	191	1,010,000.00	1,060,000.00	1,060,000.00	1,058,583.66	99.87	99.87
Investime Kapitale	131	5,254,228.00	6,749,669.70	6,749,669.70	6,725,328.52	99.64	99.64
Totali:		18,981,085.00	22,228,042.94	22,228,042.94	21,556,346.89	96.98	96.98

- Sqarim: Dallimi ndërmjet buxhetit fillestar dhe final është për arsye të bartjes së mjeteve, donacionet dhe grantet.



TË HYRAT VETANAKE

- Të hyrat e përgjithshme vetanake të planifikuara për vitin 2025, janë 2,001,711.00 euro, për këtë periudhë janë realizuar në shumë 2,253,410.94 € apo 251,669.94 (12.57%) tejkalim të planifikimit vjetor.

SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

- Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, Sektori i Tatimit në Pronë ka realizuar të hyra në shumë prej 947,547.16 euro apo 35.08% tejkalim të planit vjetor (planifikimi vjetor 701,443.00).
- Regjistrimet e reja janë 240 objekte, ose 43,305 m². Verifikimi i objekteve: 3562 ose 577,301 m².

Për arsye të përditësimit të programit të Tatimit në Pronë nga Departamenti i Tatimit në Pronë, nuk ka qenë e mundur të gjenerohen të dhëna të ndara për tatimin e objekteve dhe të parcelave dhe në këtë rast janë llogaritur së bashku.

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

AKTIVITETET

- Është bërë shqyrtimi dhe përgjigjja me kohë në kërkesat e ndryshme të qytetarëve, kryesisht për ndihma momentale – financiare, prej të cilave: 486 janë të miratuara;
- Ofrimi i shërbimeve mjekësore në dy ndërrime në dy QMF-të në Krushë të Madhe dhe në Ratkoc, shërbimet mjekësore me dy ndërrime tanimë janë të përhershme;
- Po vazhdon funksionimi shërbimit mjekësor "Kujdesi shtëpiak";
- Janë kryer vizitat sistematike të nxënësve në shkollat e komunës së Rahovecit;
- Në QKMF "Fahredin Hoti" në Rahovec, funksionon aparati i mamografisë, i cili shërben për ta identifikuar dhe diagnostikuar me kohë kancerin e gjirit;
- Janë mbështetur OJQ-të që ofrojnë shërbime sociale;
- Janë evidentuar dhe shpërndarë thirrje-ftesat për vaksinimin e fëmijëve në komunën tonë.

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Vazhdon furnizimi me barna nga lista esenciale nga buxheti i komunës;
- Vazhdon rinovimi i objekteve të QMF-ve;
- Është bërë përrurimi i objektit të QMF-së në Ratkoc
- Është bërë përrurimi i repartit të hemodializës.

Mirëqenia Sociale

Komisionet kanë punuar vazhdimisht në terren për evidentimin e familjeve në kushte të rënda sociale - është intervenuar në të gjitha rastet që është krijuar mundësia, duke bashkëpunuar me donatorë vendorë e të huaj, shoqata të ndryshme joqeveritare, grupe ekspertësh etj.

Raporti i shërbimeve në QKMF, periudha janar - dhjetor 2025

Në QKMF janë dhënë shërbime, si: I.M. (49277); I.V. (2566); infusione (15191); dhënie të serumit (1007); intervenime të vogla kirurgjike (635); perp. e plagës pa qepje (7918); perp. e plagës me qepje (959); shpëlarje e veshit dhe syrit (1559); nxjerrje e trupit të huaj (370); inhalime dhe shërbime të tjera (18402). Totali i shërbimeve: 97884.

DREJTORIA PËR ARSIM

Është hartuar Plani i Menaxhimit për kontratën e projektit “Digjitalizimi dhe audio-vizualizimi i materialeve mësimore në ShFMU-të e Komunës së Rahovecit”.

Nisja e procedurave të prokurimit për: “Instalimi dhe montimi i kamerave të sigurisë në objekte publike”; “Furnizimi me material teknik”; “Furnizimi me material higjieniko-sanitar për shkollat”; “Rregullimi dhe mirëmbajtja e hidrosanitarisë dhe makinerisë në hapësirat e jashtme dhe të brendshme në institucionet publike”; “Rregullimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve elektrike në institucionet publike”; “Ndërtimi i rrethojave të oborreve të shkollave” (nisur në dy periudha të ndryshme).

Është lidhur kontrata për projektin: “Rregullimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve elektrike në hapësirat e brendshme dhe të jashtme në institucionet publike”.

Janë pranuar furnizimet e radhës me pako pedagogjike për mësimdhënësit e të gjitha niveleve.

PROJEKTE KAPITALE:

SHFMU “Hamëz Thaçi” – Xërxë - Punimet kanë rifilluar në ndërtimin e objektit; SHFMU “Katër Dëshmorët” – Ratkoc - Vazhdim i punimeve: Lyerja dhe fasadimi i mureve të brendshme; Fasadimi i pjesës së përparme të objektit, si dhe izolimi; Përfundimi i dysHEMEVE të korridoreve dhe klasave; SHFMU “Milaim Krasniqi” – Pastasel - Ndërtimi i mureve të ndarjeve të brendshme; Çerdhja e Fëmijëve – Lagjja e Epërme - Vazhdim i punimeve në ndërtimin e objektit.

Riparimi i kulmit të shkollës “Nesimi Elshani” – Nagac; Riparimi i nyjave sanitare në SHFMU “Katër Dëshmorët” – Ratkoc; Punime të tjera riparimi në elemente sanitare në dy objekte shkollore në Xërxë.

Ka përfunduar instalimi i kamerave të sigurisë në: SHFMU “Isa Boletini” – Rahovec; IAAP “Selajdin Mullaabazi – Mici” – Rahovec; SHFMU “Rilindja”.

- **Janë nënshkruar kontratat me studentët përfitues të bursës komunale: 203 bursa për studentë dhe 50 bursa për nxënës.**

DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

Spektori për Ekonomi

Të hyrat në taksa komunale:

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat në taksë komunale, janar-dhjetor 2025	51,087.00€

Spektori për Zhvillim

Në periudhën janar-dhjetor 2025, janë lëshuar gjithsej 65 pëlqime të punës.

Të hyrat nga qiratë:

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat nga qiratë, janar-dhjetor 2025	88,847.78€

Zyra e QKRB-së

Tabela e kërkesave dhe e regjistrimit të bizneseve për periudhën janar - dhjetor 2025:

Nr.	Përshkrimi	Nr.
1.	Biznese të reja	181
4.	Informata të bizneseve	65
5.	Shuarje të biznesit	19

6.	N.U.I.	7
7.	Lëndë të anuluar	5
8.	Certifikata duplikate	18
9.	Historiat biznesi	2
10.	Ndryshime në biznes	39
11.	Vërtetim individual	15
	Gjithsej lëndë të përfunduara:	351

Menaxhimi i aseteve komunale

Përgatitja e raportit në SIMFK dhe e-pasuria; zhvlerësimi i aseteve mbi dhe nën 1,000 euro; shitja e aseteve të papërdorura nëpërmjet ritenderimit; regjistrimi i të gjitha aseteve komunale.

Sektori i Turizmit

Pjesëmarrje dhe kontakte të rregullta me organizatën e UNDP-së në lidhje me projektin: Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2 - ReLOad2; monitorimi i tre praktikanteve në kuadër të projektit të UNDP-së, skema: Praktikë në punë në kuadër të projektit ReLOad2; mbajtja e kontakteve të rregullta me të gjithë përfaqësuesit e verarive dhe të bodrumeve të komunës së Rahovecit.

Indikatorët e performancës:

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm ka vetëm dy indikatorë të performancës të cilët janë realizuar 100%.

- Treguesi: 16.1.1 - Strategjia për zhvillim ekonomik lokal - 100%.
- Treguesi: 16.1.2 - Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim - 100%.

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

SEKTORI I URBANIZMIT DHE I PLANIFIKIMIT

	janar - nëntor 2025					
kërkesat	nr. total	miratuar	refuzuar	në shqyrtim	ceduar	hidhet
leje ndërtimi	60	49	0	11		0
leje përdorimi	3	2	0	1		0
leje rrënimi	12	9	0	3		0
kushte ndërtimore	95	69	2	16		8
shkresa	85	40	0	40	4	1
pëlqime	25	16	1	6	2	0
legalizim i objekteve	29	25	0	4		0
gjithsej	309	210	3	81	6	9

Të hyrat e përgjithshme

Janar – nëntor 2025

parallogaria	31809.69 €
leje rrërimi	30 €
leje përdorimi	80 €
vërtetim – pëlqim	1100 €
legalizim	7190 €
totali i të hyrave	40209.69 €

SEKTORI I MJEDISIT

janar-nëntor 2025					
	nr. total	miratuar	refuzuar	në shqyrtim	hidhet
leje mjedisore	21	21	0	0	0
gjithsej	21	21	0	0	0
totali i të hyrave	2450.55 euro				

- **Hartimi i Hartës Zonale 2026–2033; Ndërtimi i Sheshit Qendror në Qytet; Ndërtimi i rrugëve në qytet – Rruga “Ibrahim Rugova”, Rr. “Xhelal hajda”, Rr. “Muharem Dina”;** Trajtimi i shtretërve të përrenjve në komunën e Rahovecit - faza e parë - rregullimi i shtretërve të përrenjve në fshatin Polluzhë dhe Malësi e Vogël, me këtë ka përfunduar edhe kjo kontratë.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Menaxhimi i rrugëve dimërore; krasitja e drunjve dekorativë; ndërtimi i pritoreve për pritjen e udhëtarëve; mirëmbajtja dhe pastrimi i hapësirave publike; eliminimi i deponive ilegale; ndërhyrje në rregullimin e shtyllave të ndriçimit publik, po ashtu ka pasur aktivitete në zgjerimin e ndriçimit publik; zëvendësimi i rreth 988 poqeve elektrike sipas kontratës ESCO;

- Marrëveshje me K.R.U. “Gjakova” për investime të përbashkëta publike, si ndërrimi i gypit të ujit të pijshëm në rrugën “Halil Hamza”;
- Po vazhdon projekti i gropave bioseptike sipas programit të EU-së, projekt nga IPA; Po vazhdon puna për gropat septike me programin e Bashkimit Evropian, në fshatrat Pataqan i Poshtëm, P. i Epërm dhe Pastasel, Retijë, Polluzhë;
- Punime në rrugën me katër korsi; riasfaltimi i rrugës “Gëzim Hamza – Piktori”;
- Po vazhdon projekti i ndërtimit të rrugës në Krushë të Madhe - rruga e “Drinit”;
- Projekti i ujërave të zeza në shtrirjen e rrjetit të kanalizimit;
- Vazhdojnë punimet në segmentin rrugor Sapniq – Nashpall - Vrajak, është bërë hapja e trasesë, mbushja, ndërtimi i urës, po vazhdon ngjeshmëria; po vazhdojnë punimet në fshatin Sapniq në ndërtim të përroit;
- Është nënshkruar memorandumi për mbështetjen e projektit të rrugës Fortesë -Sapniq, me vlerë 650,000.00 euro;
- Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatin Malësi e Vogël, rruga nga varrezat, e gjatë 1200 metra;
- Ka përfunduar riasfaltimi i rrugëve “Avdullah Bugari” dhe “Mizahir Isma” 1670 metra, është vendosur po ashtu edhe sinjalizimi;
- Projekti i ndërtimit të rrugës në Çifllak në rrugën “Kazniku”; kanë përfunduar 4 segmente rrugore në fshatin Ratkoc.

Performanca komunale dhe indikatorët e shërbimeve publike

6 fusha dhe 23 tregues janë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike



Fusha 8: Hapësirat Publike - janë 3 tregues, në përqindje prej 48.99, 84.16 dhe 81.71 %), totali 71.62 %, **ndërsa synimi është rritja në përqindje totale deri në 90%;**

Fusha 9: Infrastrukturë rrugore - në këtë fushë janë gjithsej 7 tregues, përmirësime kemi në shtigjet urbane të biçikletave, është rritur përqindja në krahasim me vitin paraprak me 72.38%, **ndërsa synimi është rritja në përqindje totale deri 80 %;**

Fusha 10: Transporti public - janë 3 tregues, në këtë fushë kemi 100 %, **synimi është të jetë po ashtu 100%;**

Fusha 11.1.: Uji i pijshëm - 2 tregues janë gjithsej, ku komuna jonë mbulohet me 100 % të mbulueshmërisë së territorit, **synimi i është që ky tregues të jetë 100 %;**

Fusha 11.1.2.: Kanalizimi - në këtë fushë janë gjithsej 3 tregues, dy tregues janë 100 %, ndërsa treguesi i tretë që i përket impiantit të ujërave të zeza është i ngrirë për shkak të kostove të mëdha që kanë këto projekte, **synimi i është që ky tregues të jetë 100 %;**

Fusha 11.1.3.: Menaxhimi i mbeturinave - janë gjithsej 5 tregues në këtë fushë. Komuna jonë është duke realizuar në tërësi planin në menaxhim të mbeturinave, sfida mbetet taksa për mbeturina që parashihet të fillojë nga viti 2024, ku pritet të implementohet në komunë si taksë 100%.

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Memorandum bashkëpunimi me Organizatën Chatar Charity për ndërtimin e 50 serrave **100 m²** - gjithsej kanë aplikuar **70** fermerë - përkrahjen e **31** familjeve me serra **100 m²**, edhe pse memorandum i nënshkruar ka qenë për 50 serra. Përfituesit e këtij projekti janë pajisur me:

- Serrë prej 100 m²,
- Sistem të ujitjes,
- Folie të zezë plastike për mbulimin e tokës,
 - Rezervuar uji me kapacitet 500 litra.
 - Kemi hapur thirrje për aplikim për fermerë vreshtarë “Përkrahja e fermerëve vreshtarë me preparate për luftimin e insektit ‘CIKADIA’” - Gjithsej kanë aplikuar **324** fermerë vreshtarë;
 - Është publikuar lista e përfitueseve për sektorin e vreshtarisë për projektet të cilët janë hartuar nga konsulenca e angazhuar nga komuna, ku nga **18** aplikacione, **15** prej tyre janë përfitues në skemën e granteve;
 - kemi mbështetur kultivimin e: 5 hektarëve me tranguj; 5 hektarëve me specia; 1 hektar me specia nga farëra hibride (për herë të parë).

Tabela 1. Të dhënat sipas aplikacioneve të fermerëve dhe diferenca mes vitit 202 - /2024 të shprehura në sipërfaqe

VITET		2023	2024	2025	Diferenca
Sektorët					Sip. Ha
Sektori i Lavërtarisë	drithëra	4,768.34	4,504.61	5,086.95	582.34
	grurë - KG	-	-	-	0.00
Sektori i Vreshtarisë	rrush	2,274.57	2,216.29	2,179.90	-36.39
	fidanë të hardhisë	124,000.00	127,000.00	120,000.00	-7,000.00
Sektori i Perimkulturës	perime	1,114.97	1,378.98	1,192.10	-186.88
	kungullore	423.16	719.27	630.66	-88.61
Sektori i Pemëtarisë		194.31	172.47	209.11	36.64
Sektori i Blegtorisë dhe i Shpezëtarisë	bletë	4,793.00	5,276.00	5,488.00	212.00
	buallicë	6.00	6.00	10.00	4.00
	bopë	1,953.00	1,966.00	2,178.00	212.00

	mëshqerra	0.00	151.00	285.00	134.00
	dhi	167.00	150.00	318.00	168.00
	dele	7,396.00	5,244.00	7,256.00	2,012.00
	pula vojëse	60,260.00	52,000.00	76,560.00	24,560.00
Bimë mjekësore dhe aromatike - BMA		8.54	10.96	9.65	-1.31
Perime në serra		27.21	28.77	60.89	32.12

Tabela 2. Të dhënat sipas aplikacioneve të fermerëve dhe diferenca mes vitit 2025 - 2024 të shprehura në euro

VITET		2023	2024	2025	Diferenca
Sektorët					Vlera në €
Sektori i Lavërtarisë	drithëra	1,490,052.36 €	1,405,488.44 €	1,586,368.55 €	180,880.11 €
	grurë - KG	-	-	-	0.00 €
Sektori i Vreshtarisë	rrush	2,397,396.78 €	2,446,784.16 €	2,406,609.60 €	-40,174.56 €
	verë	294,518.32 €	181,955.66 €	628,512.64 €	446,556.98 €
	fidanë të hardhisë	18,600.00 €	19,050.00 €	18,000.00 €	-1,050.00 €
Sektori i Perimkulturës	perime	636,805.38 €	1,258,835.70 €	1,118,830.54 €	-140,005.16 €
	kungullore	175,984.14 €	305,176.08 €	280,043.64 €	-25,132.44 €
Sektori i Pemëtarisë		97,932.24 €	86,924.88 €	136,757.94 €	49,833.06 €
Sektori i Blegtorisë dhe i Shpezëtarisë	bletë	95,860.00 €	105,520.00 €	137,200.00 €	31,680.00 €
	buallica	0.00 €	900.00 €	1,800.00 €	900.00 €
	lopë	175,770.00 €	176,940.00 €	196,020.00 €	19,080.00 €
	mëshqerra	0.00 €	7,550.00 €	14,250.00 €	6,700.00 €
	dhi	4,175.00 €	4,500.00 €	9,540.00 €	5,040.00 €
	dele	184,900.00 €	131,100.00 €	217,680.00 €	86,580.00 €
	pula vojëse	27,719.60 €	26,000.00 €	38,280.00 €	12,280.00 €
BMA		4,304.16 €	5,523.84 €	4,863.60 €	-660.24 €
Perime në serra		24,597.84 €	26,008.08 €	55,044.56 €	29,036.48 €
Gjithsej:		5,628,615.82 €	6,188,256.84 €	6,849,801.07 €	661,544.23 €

Grantet 2025 – MBPZhR

Rahovec	Numri i aplikacioneve	Vlera e projekteve
Aplikacione të miratuara	29 projekte	880,150.00 €
Në rregull me pikë (rezervë)	9 projekte	382,360.00 €
Aplikacione të refuzuara	9 projekte	300,510.00 €
Në pritje të rezultateve	1 projekt	50,000.00 €

Ka përfunduar procesi i vaksinimit dhe i kontrollit të bagëtive nëpër ferma - janë vaksinuar 7,855 dele dhe 2,353 lopë.

Projektet e investimeve kapitale

Kanali i kullimit të tokave bujqësore Fortesë-Celinë - faza e dytë

Kanali i kullimit nga Shtavica deri në Fortesë

Kanali i kullimit në Çifllak:

Rrugët Fushore: Janë përfunduar 4 segmente në Hamoc në Rahovec; punime në një segment rrugor që lidh fshatin Celinë - Brestoc me qytetin e Rahovecit; një segment në Brestoc, 3 segmente në Nagac, ndërsa aktualisht është duke u punuar në një segment që lidh fshatrat Polluzhë dhe Kaznik. Në fshatin Çifllak janë kryer 3

segmente.

Ka përfunduar ndërtimi i urës që lidh fshatrat Vrajakë dhe Ratkoc. Ndërkohë janë duke vazhduar punimet te ura në Rimmik në ndërtimin e këmbëve të urës.

- Ndërtimi i Serrave
- Hapja e rrugëve – rrugë fushore në Opterushë – Zoqisht.

Thirrje për aplikim – pagesa direkte

Pagesa direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë; pagesa direkte për therjet e raportuara të gjedhit, grumbullimin, si dhe përpunimin e nënprodukteve shtazore-mbetjeve; pagesa direkte për viçat për majmëri; pagesa direkte për akuakulturë; pagesa direkte për zogj për majmëri; subvencionimi për sasi-kg të grurit të dorëzuar.

Numri total i fermerëve që kanë aplikuar në këtë thirrje është: **602**.

- Është mbajtur festivali i perimekulturës “AgroFesta” në Krushë të Madhe;
- Është mbajtur festivali i rrushit “Hardhfest”.
- Është bërë shpërndarja e dyllit për bletë. Përfitues kanë qenë 64 fermerë, me një sasi totale të dyllit të shpërndarë prej 1.616 kg, si dhe pajisjeve për tymosje (64) dhe bluzëve për bletari (64 komplete).
- Ndërtimi i objektit “depo bujqësore”.

DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Spektori:	Lëndët:	Shuma në €
Kadastër dhe Pronë	920	35,460€
Gjeodezi	650	21,500€
Referenti	4010+50 (L.Z.)	16,040€
Totali	5,580+50 (L.Z.)	73,000€

- Pranimi i aplikacioneve të qytetarëve dhe të gjeodetëve privatë për ndarje të parcelave, bashkim të parcelave, regjistrim të pjesës së ndarjes, regjistrim të hipotekave, çregjistrim të hipotekave, shitblerje, trashëgimi, falje, ndërrim të paluajtshmërisë, ndarje të bashkësisë familjare etj.;
- Kërkesa për certifikatat e pronës dhe kopje të planit;
- Pranimi i lëndëve për ndarje fizike, produkte, si: koordinata, modifikime dhe punë të tjera të cilat janë kryer nga sektori i gjeodetëve;
- Kemi përgatitur materialin për dhënien e pronës me qira, interes të përgjithshëm, vendim për këmbim etj.;
- Me kërkesë të qytetarëve/grupeve të interesit (komuniteteve) kemi përgatitur material për mbledhje të kuvendit;
- Me kërkesë të qytetarëve për falje të pronës private në pronë publike në të gjitha zonat kadastrale për hapje të rrugëve publike në interes të përgjithshëm, gjeodetët kanë dalë në terren dhe kemi përgatitur dokumentacionet e nevojshme për zhvillimin e këtyre procedurave;
- Sipas legjislacionit në fuqi kemi përgatitur listën e veçantë dhe listën e përgjithshme të pronave, të cilat planifikojmë t’i japim me qira brenda vitit 2026;
- Ka vazhduar procesi i digjitalizimit kadastral - rirregullimi i vektorit;
- Ka filluar procesi i rindërtimit kadastral në dy zona kadastrale në Bellacërkë dhe në Ratkoc.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

- Mbështetja e 30 OJQ-ve përmes thirrjes publike për subvencionim, në vlerë prej **223.800 euro**, krahasuar me vitin e kaluar, kemi një rritje mbi **18.6%** të subvencioneve;
- Aktivitete përkujtimore e kulturore; Festivali “Anadrinia Jehon”;
- Aktivitete për muajin e mërgimtarëve;
- Rregullimi i **terreneve sportive** në: Nagac, Retijë, Pataqan të Poshtëm, Pastasel;
- Ndërtimi i parqeve dhe i këndeve të lojërave për fëmijë në: Xërxë, Nagac, Pataqan të Epërm, si dhe janë ndërtuar 36 parkingje afër objektit të shoqatës “Hareja”.

PALESTRA E SPORTEVE “MIZAHIR ISMA” - Për herë të parë është zhvilluar ndeshja ndërkombëtare në futsal në mes të kombëtares së Shqipërisë dhe të Danimarkës; Zhvillojnë ndeshjet klubet e hendbollit, të futsallit, të basketbollit etj. Zhvillohen aktivitete e turnirë të ndryshëm.

► BIBLIOTEKA KOMUNALE “SULEJMAN KRASNIQI”-RAHOVEC

- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit

Shërbime me libra gjatë muajve janar- dhjetor: 498 vajza dhe 321 djem.

Fondi total i librave në bibliotekën komunale “Sulejman Krasniqi” në Rahovec, është: 27981 libra. Në bibliotekën në Rahovec janë: 21583 libra, në Krushë të Madhe: 4558 libra dhe në Ratkoc: 1840 libra.

DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

1. SEKTORI I NDËRTIMIT

- Janë kryer 123 inspektime dhe riinspektime në terren; janë shqiptuar 71 gjoba mandatore për ndërtime pa leje; në rast të parregullsive teknike ose procedurale, janë lëshuar vendime për ndërprerjen e punimeve.

2. SEKTORI I MJEDISIT

- Janë realizuar kontrole të rregullta nga inspektori i mjedisit; janë shqiptuar 65 gjoba mandatore për ndotje të mjedisit; janë inspektuar 23 biznese që ushtrojnë veprimtari të ndjeshme për mjedisin; 21 prej tyre kanë aplikuar për leje mjedisore, 16 janë pajisur, 1 është refuzuar dhe 5 janë në proces shqyrtimi.

RISI E KËSAJ PERIUDHE:

Pas themelimit të fondit për shpërblim të raportimeve qytetare për ndotje, është regjistruar rritje e ndjeshme e numrit të raportimeve për raste të ndotjes mjedisore. Kjo nismë ka përmirësuar efikasitetin e sektorit dhe ka fuqizuar rolin aktiv të qytetarëve në ruajtjen e mjedisit të pastër dhe të shëndetshëm.

3. SEKTORI I ÇËSHTJEVE KOMUNALE

- Janë shqiptuar 20 gjoba për shkelje të rregullave për përdorimin e hapësirave publike; janë lëshuar 36 aktvendime kundrejt K.R.U. “Gjakova” për garantimin e zhvillimit të ligjshëm të aktiviteteve të saj; 101 shfrytëzues të hapësirave publike janë urdhëruar të pajisen me leje të rregullta.

4. SEKTORI I TREGUT

- Janë kryer inspektime të rregullta në dyqane dhe në markete; janë shqiptuar 2 gjoba mandatore për mungesë dokumentacioni dhe mospërputhje në çmime; janë verifikuar peshoret në tregjet e bukës për saktësi të matjeve; 33 biznese të reja janë regjistruar në ARBK pas ndërhyrjes së inspektoratit.

5. SEKTORI I TRANSPORTIT PUBLIK DHE KOMUNIKACIONIT

- Janë monitoruar linjat e autobusëve dhe shërbimet e transportit të licencuar; janë kontrolluar autotaksitë dhe është urdhëruar vazhdimi i lejeve për transport udhëtarësh; janë ndërmarrë masa për të garantuar një transport publik të sigurt dhe në përputhje me normat e parashikuara.

Totali i të hyrave në DPI: 33,810.00€.

DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

- Inspektimi i lumenjve, i përroskave dhe i kanaleve të hapura në të gjithë territorin e Komunës; Inspektimi i rregullt i objekteve publike, private dhe shëndetësore për verifikimin e gjendjes së aparateve për shuarjen e zjarreve.
- Servisimi i aparateve për fikjen e zjarrit në 70 objekte publike të komunës, janë servisuar gjithsej 558 aparate të vendosura në objektet e Komunës së Rahovecit dhe të zyrave të administratës publike në të gjithë territorin e Komunës, në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme, në çerdhe, në QKMF dhe në QMF-të, në shtëpitë e kulturës, në muze dhe në palestrën e sporteve.
- Inspektori për parandalim ka pasur 11 verifikime për dhënien e pëlqimit për mbrojtje nga zjarri për ndërtimin e objekteve dhe 18 dalje për verifikimin dhe hulumtimin e shkaqeve të zjarreve të ndodhura.
- Janë hartuar dy dokumente të rëndësishme:
 - Dokumenti mbi rreziqet dhe masat e sigurisë për muajt korrik dhe gusht
 - Dokumenti për Ngritjen e Gatishmërisë Emergjente për muajt korrik dhe gusht
- Është formuar grupi punues për hartimin e Planit Operativ Emergjent
- Komisioni komunal për vlerësim të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, ka vlerësuar 345 kërkesa për vlerësim të dëmeve, kryesisht në kultura bujqësore dhe në serra.
- Rinovimi i objektit të zjarrfikësve dhe i oborrit në të cilin gjendet objekti
- **Treguesit e performancës: Fusha 6 - Menaxhimi i fatkeqësive, Indikatorët e performancës**
- Niveli i realizimit të Planit Komunal për Reagim Emergjent, për çdo fatkeqësi natyrore e cila është me rrezikshmëri të lartë, aktivizohet Plani i Reagimit Emergjent Komunal, në të cilin plan janë të detajuara detyrat dhe përgjegjësitë e çdo institucioni që vepron në komunë.
- Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera - të gjitha këto informata janë nga NJPZSh-Rahovec, po ashtu, me këto të dhëna janë të informuar edhe AME-MPB. Për çdo muaj, këto informata përcillen në këto institucione.

PËRFUNDIM

Ky raport përmbledhës paraqet theksat kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Raporti i punës për vitin 2025, është dëshmi e respektit ndaj Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe i dedikohet të zgjedhurve nga qytetarët, monitoruesve dhe publikut të gjerë.

Mirëpresim kontributin e secilit që përmes vërejtjeve, këshillave, plotësimeve apo të dobësive eventuale, që t'i bëjmë bashkërisht përmirësimet e nevojshme, në mënyrë që në të ardhmen ta bëjmë sa më mirë punën tonë.

Bashkërisht me ekipin tim qeverisës, kemi gatishmërinë, energjinë dhe diturinë, të gjitha këto t'i vëmë në dispozicion të qytetarëve, që Komuna e Rahovecit të ofrojë shërbime sa më cilësore.

Të vendosur për menaxhim të mirë të pronës publike, duke krijuar kushte më të mira për zhvillim ekonomik, arsim, shëndetësi, bujqësi, infrastrukturë, mirëqenie sociale, kulturë, rini dhe sport, në të ardhmen na presin angazhime edhe më të mëdha për të mirën e të gjithëve, pa dallim.

Ju faleminderit!

Rahovec, dhjetor 2025

